VENDIM
Nr. 187, datë 27.3.2024

PËR FINANCIMIN E VEPRIMTARISË SË FONDACIONIT *"DURRAH CITY FOOTBALL ACADEMY",* PËR VITIN 2024

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 7, pika 2, dhe 19, pika 4, të ligjit nr. 79/2017, "Për sportin", të ndryshuar, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 97/2023, "Për buxhetin e vitit 2024", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përdorimin e fondit prej 90 000 000 (nëntëdhjetë milionë) lekësh, të miratuar në buxhetin e vitit 2024, për Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, në programin buxhetor 08140, "Për zhvillimin e sportit", në llogarinë ekonomike 604, "Transferta të brendshme", për financimin e shpenzimeve të ushtrimit të veprimtarisë së fondacionit "*Durrah City Football Academy*".
2. Fondi i përcaktuar, sipas pikës 1 të këtij vendimi, transferohet në llogarinë e fondacionit, në bankën e nivelit të dytë.
3. Fondacioni "*Durrah City Football Academy*", brenda muajit mars të vitit 2025, dërgon në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit raportin e shpenzimeve të realizuara për vitin 2024, të miratuar nga bordi drejtues i fondacionit.
4. Fondet buxhetore, që do t'i akordohen fondacionit nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, duhet t'u nënshtrohen rregullave të menaxhimit financiar dhe kontrollit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për menaxhimin financiar dhe kontrollin.
5. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Sportit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama